



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.832/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.12.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Mend Oil” sh.p.k, nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-84267-08-30-2018 me objekt “Furnizim me karburant për automjete”, me fond limit 37,317,300 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.

Ankimues:

“Mend Oil” shpk
Lagjia “Ali Demi”, Rruga “Mustafa Gerblleshi”, pallati Santar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Eco Tirana Sh.a
Rruga Don Bosko, ish parku i autobusave.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.08.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-84267-08-30-2018 me objekt “Furnizim me karburant për automjete”, me fond limit 37,317,300 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.

II.2. Në datën 01.10.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 12.10.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- 2A Trade&Engineering	pa ofertë	I skualifikuar
- Resuli Er	pa ofertë	I skualifikuar
- Europetrol Durrës	pa ofertë	I skualifikuar
- Das Oil	9.6%	I skualifikuar
- A&T	12%	I skualifikuar
- Mend Oil	16.9%	I skualifikuar

II.4. Në datën 12.10.2018 operatori ekonomik “Mend Oil” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik nuk ka permbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, piken: ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje); operatorët ekonomik nuk kanë plotësuar formularin e ofertes sipas percaktimeve të nenit 74 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, pika 1 "Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi." oferta ekonomike nuk është plotësuar nga të dy operatorët në marreveshje bashkëpunimi dhe nuk është percaktuar pjesa e secilit operatore.*

II.5. Në datën 18.10.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Jemi para fakteve ku asnjëra nga palët në këtë bashkëpunim nuk ka deklaruar se do të përzgjedhi të kryejë një pjesë të shërbimit apo të furnizimit vecmas pasi kemi të bëjmë vetëm me një produkt Diesel 10 ppm me masë të caktuar (dhe jo më shumë produkte) por palët bashkërisht dhe të shprehura qartazi si në kontratën e bashkëpunimit ashtu edhe me vullnetin e tyre kanë deklaruar se autoriteti kontraktor do të furnizohet në të gjitha stacionet ku janë me logo Mend Oil dhe Kastrati pa qenë e nevojshme të shprehet pjesa e ndarjes së fitimit pasi në realitet po të shprehet ndarja e fitimit sipas furnizimeve do të ishte e pamundur realizimi i objektit të këtij tenderi. Në ansjë rast dhe në ansjë dokument nuk është shprehur nga ky bashkim operatorësh në këtë procedurë d të jetë i ndarë me pjesët e shërbimit apo të furnizimit lidhur me objektin e kësaj procedure. Sa më sipër skualifikimi i shoqërisë sonë është i padrejtë .*

II.6. Në datën 24.10.2018 me shkresën nr. 659/10 prot operatori ekonomik ankimues “Mend Oil” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 29.10.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 659/12 prot datë 07.11.2018 protokolluar me tonën me nr.1653/2 datë 13.11.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mend Oil” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “*Operatori ekonomik nuk ka permbushur KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, piken: ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje); operatores ekonomik nuk kane plotesuar formularin e ofertes sipas percaktimeve te nenit 74 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, pika 1 "Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi." oferta ekonomike nuk eshte plotesuar nga te dy operatores ne marreveshje bashkepunimi dhe nuk eshte percaktuar pjesa e secilit operatore*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Mend Oil” & “Kastrati” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.3898 Rep Nr.1931/1 Kol datë 28.09.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “*Furnizim me karburant për automjetet*”, me fond limit 37,317,300 leke pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Eco Tirana sha.

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Të dyja shoqëritë bien dakord për bashkimin e kapaciteteve teknike, ekonomike, financiare, administrative, ligjore për kryerjen me sukses të furnizimeve me karburant për autoritetin kontraktor. Kryerjen e të gjithë furnizimeve në këtë bashkëpunim. Palët deklarojnë se bashkëpunimi për kryerjen e furnizimeve do të jetë në raportin 97% për shoqërinë Mend Oil dhe 3 % për shoqërinë Kastrati. Shoqëria Mend Oil do të ofrojë 97 % të sasisë së furnizimit me karburant të parashikuar në grafikun e lëvrimit. Kjo përqindje do të shërbejë dhe për ndarjen e fitimeve. Shoqëria Kastrati shpk do të ofrojë 3% të sasisë së furnizimit me karburant të parashikuar në grafikun e lëvrimit. Kjo përqindje do të shërbejë dhe për ndarjen e fitimeve. Shoqëria Mendoil dhe shoqëria Kastrati marrin përsipër

furnizimin me karburant Gazoil 10 ppm nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar me targat e mjeteve që ka në përdorim AK të cilat janë pa datë skadence dhe të konsumueshme edhe gjatë vitit 2019 me shërbim 24 orë pranë të gjithë distributorëve të tregëtimit me pakicë të karbuanteve të shpërndara në teritorin e Bashkisë Tiranë sipas kërkesave të AK në DT nën administrimin e shoqërisë Kastrati dhe shoqërisë Mend Oil shpk. [...]”

III.1.2. Në shtojcën 2 “Formulari i Ofertës Ekonomike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 2

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. *Marzhi ynë i fitimit i shprehur në përqindje është si më poshtë:*

1	2	3	5
Nr	Përshkrimi i mallrave	Marzhi i fitimit i shprehur në përqindje	Afati i levrimit
1	Furnizim me karburant per automjete		12 muaj nga nenshkrimi i kontrates sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor

--	--	--	--

Nëshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: Naftë Diesel 10 ppm

- Densiteti në 15 °C (kg/m ³)	820-845
- Numri i cetanit	min 51
- Indeksi i cetanit (Ilog)	min 46
- Temperatura flakërimit °C	mbi 55
- Përmbajtja e squfurit (mg/kg)	max 10
- Viskoziteti kinematik në 40 °C	2-4.5 (mm ² /s)
- Mbetja e karbonit (në 10 % mbetje distilimi) %(m/m)	max 0.3
- Përmbajtja e ujit (mg/kg)	max 200
- Ndotja e përgjithshme (mg/kg)	max 24

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Mend Oil” shpk ka dorëzuar “Formularin e Ofertës” të plotësuar sipas shtojcës 2 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi duke ofertuar me marzh fitimi të shprehur në përqindje në masën 16.9%.

III.1.4. Në nenin nenin 46, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të

vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.5. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

III.1.6. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik “Mend Oil” shpk me arsyetimin se operatorët ekonomik nuk kane plotësuar formularin e ofertes sipas percaktimeve te nenit 74 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, pika 1 "Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi." oferta ekonomike nuk është plotësuar nga te dy operatorët ne marreveshje bashkepunimi dhe nuk është percaktuar pjesa e secilit operatore”, KPP vëren se operatori ekonomik “Mend Oil” shpk në këtë procedurë ka marrë pjesë si bashkim operatorësh së bashku me shoqërinë “Kastrati” sha. Për këtë është paraqitur Kontrata e Bashkëpunimit lidhur para një noteri publik e cila ka përcaktuar në mënyrë të qartë përqindjen e pjesëmarrjes në këtë bashkëpunim për secilin anëtar të bashkimit të operatorëve në masën 97 % për shoqërinë “Mend Oil” shpk dhe 3% për shoqërinë Kastrati sh.a. Gjithashtu KPP vëren se është dorëzuar formulari i ofertës sipas shtojës 2 të dokumentave të procedurës nga ku rezulton se është ofertuar me marzh fitimi në masën 16.9 %. KPP gjykon se referuar natyrës së vecantë të objektit të prokurimit ku dhe mënyra e ofertimit ndryshe nga procedurat e tjera është me marzh fitimi të shprehur në përqindje dhe në kushtet kur kontrata e bashkëpunimit ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe pa asnjë ekuivok masën e përqindjes për secilin nga anëtarët e bashkimit si dhe ka shprehur qartë pjesën e furnizimit për secilin prej anëtarëve, arsyetimi i autoriteti kontraktor se në ofertë nuk është përcaktuar pjesa e secilit operator nuk është e bazuar dhe nuk ndikon në ndarjen e pjesës së furnizimit apo përgjegjësi për realizimin e kontratës nga secili prej anëtarëve të bashkimit. Akoma më tej referuar shtojcës 10 “Specifikimet teknike”, KPP konstaton se autoriteti kontraktor këkon furnizimin me Naftë Diesel 10 ppm me karakteristikat e sipërcituara. Në rastin konkret nuk jemi përballë kontratave me shumë zëra apo me zëra voluminoz për të cilat të kërkohet një ndarje e detajuar e zërave në preventivat përkatës në të cilën të pasqyrohet

konkretisht se cili prej anëtarëve ka marrë përsipër realizimin e secilit zë. KPP gjykon se malli i prokuruar nga autoriteti kontraktor Naftë Diesel 10 ppm merret përsipër të furnizohet nga të dy anëtarët e bashkimit në masën e përcaktuar shprehimisht në kontratën e bashkëpunimit në përputhje me nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mend Oil” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

- 1- Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Mend Oil” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-84267-08-30-2018 me objekt “*Furnizim me karburant për automjete*”, me fond limit 37,317,300 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 01.10.2018 nga autoriteti kontraktor, Eco Tirana sha.
- 2- Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Mend Oil” shpk duke e kualifikuar atë.
- 3- Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
- 4- Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Mend Oil” shpk.
- 5- Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1653 Protokolli; Datë 29.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha